



POLITIKA E INTEGRITETIT E FONDIT PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE PËR VITIN 2026



Fondi për Sigurimin e Depozitave, duke u nisur nga angazhimet për garantimin e respektimit të kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit profesional, transparencës dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, solli këtë:

POLITIKË TË INTEGRITETIT

Integriteti, si themel i qeverisjes së mirë dhe si përgjigje strategjike dhe e qëndrueshme ndaj korrupsionit, është thelbësor për prosperitetin ekonomik, social dhe shoqëror.

Me integritet nënkuptohet ushtrimi ligjor, i pavarur, i paanshëm, etik, i përgjegjshëm dhe transparent i detyrave, përmes të cilit të punësuarit/nëpunësit administrativë në Fondin për Sigurimin e Depozitave ruajnë reputacionin e tyre dhe reputacionin e institucionit ku janë të punësuar, eliminojnë rreziqet dhe largojnë dyshimet për mundësinë e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, duke siguruar kështu besimin e qytetarëve në ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

Duke pranuar Politikën e Integritetit, Fondi për Sigurimin e Depozitave obligohet për:

1. vendosjen e një sistemi të integritetit në institucion,
2. zbatimin dhe mbështetjen e sistemit të integritetit dhe
3. ndjekjen dhe raportimin për zbatimin e sistemit të integritetit.

1. VENDOSJA E SISTEMIT TË INTEGRITETIT

Në Fondin për Sigurimin e Depozitave, sistemi i integritetit është vendosur në mënyrë që t'i mundësojë Fondit të kryejë kompetencat e përcaktuara me Ligjin e posaçëm për Fondin për Sigurimin e Depozitave, në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore dhe standardet më të larta etike.

Sistemi i integritetit bazohet në këta elemente, të cilët përfaqësojnë standarde të integritetit:

- mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- respektimi i kodit etik për të punësuarit në Fondin për Sigurimin e Depozitave;
- menaxhimi i burimeve njerëzore mbi bazën e meritës dhe kualifikimeve;
- menaxhimi i qëllimshëm, racional dhe efikas i burimeve;
- transparenca dhe qasja në informacionet me karakter publik;
- raportimi i mbrojtur nga sinjalizuesit dhe
- menaxhimi i cilësisë.



Mbrojtja e interesit publik dhe parandalimi i konfliktit të interesit

Fondi për Sigurimin e Depozitave dhe të punësuarit e tij obligohen që në punën e tyre t'i japin përparësi interesit publik ndaj atij privat dhe të zhvillojnë kulturë organizative që nuk toleron konflikt interesi, ku përgjegjësia individuale dhe shembulli personal janë bazë e qeverisjes së mirë.

Në Fondin për Sigurimin e Depozitave për menaxhim efikas të konfliktit të interesit, zbatohen procedura për identifikimin dhe deklarimin e interesave personale, përcaktohen rregulla të qarta për veprimet e të punësuarve në rast rreziku për konflikt interesi, sigurohet transparencë në zgjidhjen e këtyre situatave dhe zhvillohen mekanizma për monitorimin e zbatimit të rregullave parandaluese.

Respektimi i kodit etik

Të punësuarit në Fondin për Sigurimin e Depozitave me status të nëpunësve administrative janë të obliguar të respektojnë kodin etik të institucionit, me qëllim promovimin e profesionalizmit, mbrojtjes së interesit publik, llogaridhënies, përgjegjësisë, paanshmërisë, mosdiskriminimit dhe neutralitetit politik.

Fondi zhvillon mekanizma për monitorimin e vazhdueshëm të respektimit të kodit etik. Për fushat më të ndjeshme ndaj korrupsionit, si furnizimet publike, miratohet edhe kod i posaçëm i sjelljes.

Menaxhimi i burimeve njerëzore mbi bazën e meritës dhe kualifikimeve

Integriteti promovohet si pjesë e menaxhimit të burimeve njerëzore. Punësimet realizohen në mënyrë transparente përmes shpalljeve publike, me kriterë të paracaktuara, duke mundësuar avancime mbi bazën e meritës dhe kualifikimeve dhe duke parandaluar ndikimet partiake dhe nepotizmin.

Janë identifikuar pozita pune veçanërisht të ndjeshme ndaj korrupsionit, për të cilat vlejné obligime shtesë për mbrojtjen e integritetit, duke respektuar papajtueshmëritë, ndalesat dhe kufizimet ligjore.

Menaxhimi i qëllimshëm, racional dhe efikas i burimeve publike

Fondi për Sigurimin e Depozitave demonstroi hapje, llogaridhënie dhe përfshirje në përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët. Kontratat për furnizime publike, qira dhe shitje të pasurisë tundshme dhe të patundshme që lidhen përmes procedurave transparente dhe ligjore që sigurojnë trajtim të barabartë të pjesëmarrësve.

Transparenca dhe qasja në informacionet me karakter publik

Fondi për Sigurimin e Depozitave siguron informacione të sakta, të përshtatshme, të plota dhe në kohë për qytetarët dhe personat juridikë, duke respektuar privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Institucioni synon nivel të lartë të transparencës aktive përmes publikimit të sa më shumë informacioneve në ueb-faqen e tij dhe vendosjes së punës së tij nën kontroll publik. Të punësuarit nuk guxojnë t'i përdorin informacionet për përfitim personal ose për të tjerët.

Denoncim i mbrojtur nga sinjalizuesit

Mundësimi i raportimit pa frikë nga pasojat është shtyllë e rëndësishme për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e veprimeve të tilla të paligjshme me të cilat rezikohet puna e institucionit. Fondi për Sigurimin e Depozitave vepron në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe ka caktuar person të autorizuar për pranimin e denoncimeve dhe raportimin e mbrojtur. Me anë të procedurës për kallzim të mbrojtur dhe personit të autorizuar, njoftohen të gjitha palët e interesuara.

Menaxhimi i cilësisë

Fondi për Sigurimin e Depozitave vendos sistem pune për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve, reduktim të rreziqeve dhe kostove, rritje të motivimit të punonjësve dhe monitorim të rezultateve, në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 9001.

2. ZBATIMI DHE MBËSHTETJA E SISTEMIT TË INTEGRITETIT

Për të mundësuar zbatimin efikas të sistemit të integritetit, Fondi i Sigurimit të Depozitave është i përkushtuar për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e të gjithë personelit administrativ/punonjësve në procesin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga standardet e integritetit në drejtim të kryerjes së detyrave të punës në mënyrë të ligjshme, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente. Strukturat drejtuese në Fondin e Sigurimit të Depozitave janë përgjegjëse për krijimin dhe zbatimin e sistemit të integritetit, si dhe për promovimin e tyre përmes sjelljes së tyre personale dhe duke marrë masa për pranimin kolektiv të politikës së integritetit dhe respektimin e saj nga punonjësit. Ndërtimi i kapaciteteve bëhet përmes edukimit të rregullt të punonjësve për zbatimin e duhur të standardeve të integritetit përmes trajnimeve, si dhe duke ofruar këshilla për të gjitha dilemat që mund të lindin për personelin administrativ në punën e tyre të përditshme. Për të siguruar zbatimin efikas të sistemit të integritetit, Fondi i Sigurimit të Depozitave emëron gjithashtu person për integriteti. Fondi i Sigurimit të Depozitave identifikon rreziqet e korrupsionit dhe i vlerëson dhe monitoron rregullisht. Në përputhje me rrethanat, po merren masa për të kapërcyer rreziqet që kërcënojnë integritetin e institucionit.

3. NDJEKJA DHE RAPORTIMI PËR ZBATIMIN E SISTEMIT TË INTEGRITETIT

Fondi i Sigurimit të Depozitave ofron një sistem dy-nivelësh të monitorimit të zbatimit të sistemit të integritetit, në nivelin e vetë institucionit dhe nga institucioni kompetent, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme i referuar KSHPK). Qëllimi i monitorimit të sistemit të integritetit në Fondin e Sigurimit të Depozitave është të përcaktojë efikasitetin e politikave dhe procedurave të aplikuara që mundësojnë zbatimin konsistent të standardeve të integritetit, si dhe të matë rezultatet e masave të aplikuara për të zvogëluar rreziqet e korrupsionit. Personi për integritetit koordinon procesin e monitorimit dhe raportimit mbi zbatimin e sistemit të integritetit. Fondi i Sigurimit të Depozitave gjithashtu kryen kontrole të brendshme për të verifikuar zbatimin e standardeve të integritetit përmes përfshirjes së auditimit të brendshëm. Fondi i Sigurimit të Depozitave merr përsipër të bashkëpunojë me KSHPK-në, duke i mundësuar asaj të monitorojë zbatimin e sistemit të integritetit. Për këtë qëllim, Fondi i Sigurimit të Depozitave është i angazhuar për të informuar



me saktësi, rregullisht dhe në kohë KSHPK-në për të gjitha aktivitetet e ndërmarra drejt zbatimit të sistemit të integritetit, si dhe për të zbatuar udhëzimet, rekomandimet dhe sugjerimet e marra nga KSHPK-ja në lidhje me forcimin e integritetit në institucione.

Drejtor
Behar Emini



Përkëthimi: Luljeta Azizi